



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

|                                                                                                         |              |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS<br>REPUBLIKA KOSOVA<br>QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE<br>CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA |              |
| Sh. U.                                                                                                  | Nr. Br.      |
| 01                                                                                                      | 11300        |
| Nr. i faq. Br. str.                                                                                     | Data: Datum: |
| 3                                                                                                       | 11/04        |
| KAMENICË/A                                                                                              |              |

Komuna e Kamenicës  
Opština Kamenica  
Kamenica Municipality



**Emërtimi i organit të komunës/Naziv opstinskog organa/ Name of the municipality structure**

Komiteti konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë  
Datë: 28.03.2024

**PROCESVERBAL**

Anëtsrët e komitetit konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë që morën pjesë në këtë takim janë:  
Basri Januzi – nga komuniteti i biznesit;  
Fatmir Krasniqi - nga komuniteti i biznesit;  
Ibadete Sadiku - nga komuniteti i biznesit;  
Kadrije Mustafa - nga komuniteti i biznesit;  
Lavdim Klaiqi – nga shoqëria civile;  
Rina Krasniqi Kryeziu – nga kuvendi komunal;  
Albana Ajvazi – nga kuveni komunal.

Në këtë takim nuk ishin prezent dy anëtar nga kuvendi komunal Labinor Skoverqani dhe Valentina Kastrati Kryeziu.

Këtë takim të parë të këtij komiteti e organizoi Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë, kurse takimet e ardhshme do të thirren nga vet komiteti.

Temat e diskutimit të këtij takimi ishin:

1. Njoftimi i anëtarëve të komitetit dhe diskutimi i çështjeve të mëposhtme
2. Plani buxhetor, plani vjetor i investimeve kapitale dhe progresi në realizimin e strategjisë zhvillimore;
3. Masat stimuluese të qytetit/komunës për ekonominë/bujqësinë dhe punësimin, nëse ekzistojnë;
4. Tarifat dhe taksat administrative dhe komunale, në fazën e planifikimit;
5. Dokumentacioni i planifikimit hapësinor (planet urbanistike lidhur me zonat afariste/industriale);
6. Çmimet dhe cilësia e shërbimeve komunale;
7. Rezultatet e anketës së sektorit të biznesit;

## 8. Mbrojtjen e mjedisit dhe mundësitë për një ekonomi të gjelbër

Takimin e hapi drejtoresha për zhvillim ekonomik dhe diasporë Burbuqe Leka, ku i përshendeeti të gjithë pjesëmarrësit dhe i ftoi anëtrët e këtij komiteti të diskutojnë rreth pikave të cilat do i trajtojnë ky komitet. Drejtoresha i prezantoj të gjitha pikat e diskutimit.

Basri Januzi : Propozoj që të funksionalizohet Parku i Biznesit si dhe të futet në planifikimin e buxhetit të vitit 2025 ashtu sic i planifikuar lokacioni sepse është i përshtatshëm për çdo biznes. Gjithashtu të shqyrtohet të hapet një rrugë e re që do ta lidh Roganën me Kamenicën gjegjësisht rruga te Joni Ranch.

Burbuqe Leka: ju a kujtoj të gjithëve që do të fillojnë takimet buxhetore në të gjitha lokalitetet dhe ju ftoj të gjithë të merrni pjesë në këto takime dhe ti jepni propozimet e juaja.

Fatmir Krasniqi: e përshëndes këtë takim dhe drejtoreshën për punën që është duke e bërë. Biznesi dhe prodhuesit janë shtresa më fisnike e Kamenicës dhe komuna duhet të ju ndihmoj bizneseve sepse Kmanica është duke u zbratur ku duhet të ju jep mundësi dhe ide që të fillojnë njerëzit të punojnë. Gjithashtu propozoj që komuna të marr më shumë fonde për investime nga qeveria ku fillimisht komuna të profilizohet pastaj dhe të investohet.

Propozim tjetër është lehtësimi i procedurave administrative gjegjësisht në urbanizëm për leje.

Propozoj që festat zyrtare të reduktohen dhe bizneset të mos mbyllen gjatë këtyre festave që nuk janë tonat.

Të mirren masa lehtësuese si psh të ulet TVSH-ja dhe disa masa lehtësuese tjera

Zhvillimi i turizmit ka potencial në Kamenicë si psh Shkolla e Tugjecit të shëndrrohet në hotel apo diqka e tillë.

Ta ndihmojë sektorin e blegtorisë dhe të identifikohet me ndonjë produkt të vetin

Idea ime është që të ipet në shfytëzim ish Bahqja e qytetit që të zhvillohet diqka që ti kthejm njerëzit në Kamenicë.

Basri Januzi: E përgëzoj Fatmirin dhe e këshilloj që idet e tij ti propozoj te Kryetari Rahimaj

Burbuqe Leka: Komuna do të shpallë thirrjen për grante dhe kërkoj nga ju të propozoni se cilave tu japim grante për vitet e ardhshme, gjithashtu jemi tu dashtë me i adasptu shkollat në bujtina ku kemi me hap thirrje për bashkëfinancim dhe ju kisha lut që ta shpërndani këtë informacion sa më shumë.

Lavdim Klaiqi: Propozoj që të mbani takime në fshatra të malësisë sepse shpesh nuk ju shkon informacioni dhe unë jam i gatshëm me ju ndihmu në lidhje me këtë lobim

Ibadete Sadiku: Propozoj që në thirrjen për grante të mbështetn gratë dhe të rinjtë më shumë.

Kadrije Mustafa: Për me ju ndihmu disa kultivuesve propozoj që të shtrohet rruga për në Gjyrishec

Fatmir Krasniqi: Nëse komuna i ka për vitin 2024 120,000.00 euro për grante atëher unë propozoj që këto grante të ju ipen 4 bizneseve e jo më shumë sepse fondet e vogla nuk janë të mjaftueshme për zhvillim të biznesit

Rina Krasniqi: Kemi me i përkrah të gjitha shqetësimet e komitetit të biznesit dhe do ti adresojmë në kuvend

Albana Ajvazi: Gjithashtu pohoj se do të përkrahen të gjitha propozimet dhe do të shkojnë në kuvend komunal.

Lavdim Klaiqi: Ky komitet i qëlluar por i formuar vonë duhet me ju kërkim me ju ndihmë m efonde bizneseve ku gjithashtu duhet të monitorohen bizneset përfituese gjithashtu për shkollat me u shëndrru në bujtina është ide shumë e mirë sepse ka shkolla që janë në gjendje shumë të mirë infrastrukturore që munden më u shëndrru në objekte turistike, ku ju si komunë duhet ti paraprini cdo nisme për tu zhvilluar turizmi.

Burbuqe Leka: Propozoj që nga ky takim të zgjidhet një kryesues i këtij komiteti që ti organizoj takimet e tjera që ti mbrojnë interesat e komunitetit të biznesit dhe ti adresoj në kuvend .

U zhvillua një votim nga anëtarët e komitetit ku të gjithë u pajtuan që Albana Ajvazi të jetë kryesuese e këtij komiteti.

Procesmbajtës.  
Valdete Sopi Birqaj

